



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenin 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01 Nr.016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës në zbatim të nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr.05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës nxjerr këtë:

V E N D I M
P Ë R
THEMELIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE AD HOC

1. Themelohet, komisioni ad hoc i ankesave për trajtimin e ankesave të nëpunësve të Shërbimit Publik në kuadër të Administratës së Shërbimit Publik në përbërje:

- 1.1 Erson Zymeri – kryesues
- 1.2 Sali Fazliu – anëtar
- 1.3 Fatushe Haliti – anëtar

2. Komisioni i ankesave ad hoc nga pika 1 e këtij vendimi ka mandat që të trajtoj ankesat aplikantëve gjer në përfundimin e procedurës së rekrutimit sipas shpalljes publike për rekrutim 02 Nr.016-125496 të datës 26.10.2022 për plotësimin e pozitës punuese Nëpunës Administrativ dhe mbështetës.

3. Me përfundimin e procedurës rekrutuese përfundon edhe mandati i komisionit

4. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit

